



MIRATIMI I LIGJEVE NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës të Republikës së Maqedonisë së Veriut, respektivisht organi i vetëm i pushtetit shtetëror që ka kompetencë të miratojë ligje.

Shumica e nevojshme për miratimin e ligjeve është e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në përputhje me Kushtetutën, Kuvendi mund të vendosë, nëse në seancë merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve (kuorumi). Kuvendi vendos me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të deputetëve (shumica e thjeshtë ose relative), vetëm nëse me Kushtetutë nuk është paraparë shumicë e posaçme (shumicë absolute ose e kualifikuar). Gjatë miratimit të ligjeve, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale, përdorimin e simboleve, duhet të ketë medoemos shumicë të votave nga deputetët e pranishëm, të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (shumicë e dyfishtë ose e ashtuquajtur shumicë e Badenterit).

Ligjet miratohen me procedurë të përcaktuar (procedura ligjvënëse), e rregulluar me Rregulloren e Punës të Kuvendit. Procedura ligjvënëse paraqet një sërë hapash, nëpërmjet të cilave duhet të kalojë propozim-ligji para se të miratohet. Në përputhje me Rregulloren e Punës, procedura kalon në tri lexime (me procedurë të rregullt).

Ligjet miratohen me procedurë të rregullt, por në raste të caktuara mund të miratohen me procedurë të shkurtuar, ndërsa në raste të jashtëzakonshme edhe me procedurë urgjente.

Të drejtën për të propozuar miratim të ligjit ka çdo deputet, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe minimum 10,000 zgjedhës, të cilët quhen propozues të autorizuar. Nismën për miratim të ligjit të propozuesit e autorizuar mund ta parashtrijë çdo qytetar, grup qytetarësh, institucione dhe shoqata.

Në përputhje me Rregulloren e Punës, propozim-ligjin propozuesit e autorizuar ia dorëzojnë Kryetarit të Kuvendit, i cili më pas ua dorëzon deputetëve me shkrim ose në formë elektronike, kështu fillon procedura ligjvënëse.



LEXIMI I PARË

Në kuadër të leximit të parë, trupat punues (komisionet) dhe Kuvendi marrin vendim nëse propozim-ligji është i pranueshëm dhe nëse mund të jepet në lexim të mëtutjeshëm. Në fillim propozim-ligji shqyrtohet në komisionin amë dhe në Komisionin Juridik-Ligjvënës, ndërsa nëse ka implikime financiare shqyrtohet edhe në Komisionin për Financim dhe Buxhet. Në fund, propozim-ligji shqyrtohet në seancën e Kuvendit.

Trupi punues amë dhe Komisioni Juridik-Ligjvënës mbajnë debat të përgjithshëm për propozim-ligjin dhe përgatitin raporte, në të cilat jepet mendim, nëse propozim ligji është i pranueshëm dhe nëse duhet të jepet në lexim të mëtutjeshëm.

Propozim-ligji pastaj shqyrtohet në seancën e Kuvendit, ku gjithashtu mbahet debat i përgjithshëm. Pas debatit të përgjithshëm, Kuvendi vendos nëse propozim-ligji mund të jepet në lexim të dytë. Nëse Kuvendi vendos se propozim-ligji është i pranueshëm dhe mund të jepet në lexim të mëtutjeshëm, miraton konkluzion, me të cilin vazhdon procedura ligjvënëse. Me konkluzionin e njëjtë, për propozim-ligjin që është me interes më të gjerë, Kuvendi mund të vendosë që të mbajë debat publik dhe të përcaktojë trupin punues amë, që do ta organizojë debatin publik. Trupi punues që është kompetent për organizim të debatit publik duhet të mundësojë qasje të propozim-ligji për të gjitha palët e interesuara (qytetarë, ente publike, institucione, OJQ, sindikata etj.), të cilët në afat të caktuar mund të dorëzojnë mendime dhe propozime në lidhje me propozim-ligjin. Në bazë të mendimeve dhe propozimeve të tyre, trupi punues amë përgatit raport nga debati, të cilin së bashku me propozim-ligjin e jep në lexim të dytë në Kuvend. Nëse Kuvendi merr vendim se propozim-ligji nuk është i pranueshëm, atëherë procedura ligjvënëse ndërpritet. Në këtë rast propozim-ligji i njëjtë nuk mund të dorëzohet në afat prej tre muajsh.

LEXIMI I DYTË

Në leximin e dytë bëhet përsëri shqyrtim i propozim-ligjit në trupat punues dhe në seancën e Kuvendit. Në këtë fazë të procedurës mund të dorëzohen amendamente. Amendamenti paraqet propozim për ndryshimin ose plotësimin e propozim-ligjit.

Leximi i dytë fillon me shqyrtimin e propozim-ligjit në komisionin amë dhe në Komisionin Juridik-Ligjvënës, që shqyrtojnë dispozitat e propozim-ligjit dhe amendamentet e propozuara nga deputetët ose grupet e deputetëve dhe i votojnë. Në këtë fazë, amendamente mund të dorëzojnë edhe trupat punues. Nëse në mbledhjet e trupit punues amë dhe të Komisionit Juridik-Ligjvënës miratohet ndonjë amendament, atëherë komisionet pas përfundimit të shqyrtimit përgatitin propozim-ligji të plotësuar (tekst të propozim-ligjit në të cilin inkorporohen amendamentet e miratuara) dhe arsyetim.

Pas shqyrtimit të propozim-ligjit në trupat punues, bëhet shqyrtimi i propozimit në seancën e Kuvendit. Gjatë leximit të dytë të ligjit në seancën e Kuvendit shqyrtohen vetëm nenet e propozim-ligjit që janë ndryshuar me amendamente dhe vetëm për këto nene mund të parashtrohen amendamente. Amendamente mund të parashtrojnë çdo deputet, grup deputetësh dhe propozuesi.

Amendamenti miratohet me shumicë votash nga deputetët e pranishëm dhe së paku një të tretën e numrit të përgjithshëm të deputetëve, pa marrë parasysh shumicën e votave të nevojshme për miratim të ligjit. Amendamenti i parashtresit të propozim-ligjit dhe amendamenti të cilin ai e ka pranuar konsiderohet pjesë përbërëse e propozim ligjit.

Nëse Kuvendi miraton më shumë amendamente se 1/3 e neneve të propozim-ligjit të plotësuar, pas përfundimit të leximit të

dytë, teksti i ligjit rregullohet nga aspekti juridik-teknik dhe përgatitet për lexim të tretë.

Nëse miratohen më pak amendamente se 1/3 e neneve të propozim-ligjit të ndryshuar, Kuvendi mund të vendosë që leximi tretë i propozim-ligjit të mbahet në seancën e njëjtë. Kryesuesi atëherë merr vendim nëse leximi i tretë do të bëhet menjëherë pas marrjes së vendimit të caktuar.

Mirëpo, nëse në seancën e Kuvendit gjatë leximit të dytë nuk miratohet asnjë amendament, atëherë nuk bëhet lexim i tretë dhe në të njëjtën seancë kalohet në votim të propozim-ligjit në tërësi.

LEXIMI I TRETË

Në leximin e tretë nuk përfshihen trupa punues dhe sipas rregullit ky lexim mbahet në seancën e ardhshme plenare pas leximit të dytë.

Edhe në këtë fazë deputetët dhe propozuesi mund të parashtrorjnë amendamente, por vetëm për nenet për të cilat janë miratuar amendamente gjatë leximit të dytë në seancën e Kuvendit.

Gjatë leximit të tretë, Kuvendi shqyrton dhe merr vendim vetëm për nenet e propozim-ligjit të plotësuar, për të cilat janë parashtruar amendamente dhe merr vendim për propozim-ligjin në tërësi.



PROCEDURA E SHKURTUAR

Procedura e shkurtuar për miratim të ligjit mund të zbatohet me kërkesë të propozuesit në këto raste: nëse nuk bëhet fjalë për ligj të ndërlikuar dhe vëllimor; nëse është shfuqizuar ligji ose dispozitë e ndonjë ligji, si dhe nëse nuk bëhet fjalë për harmonizime të ndërlikuara dhe të mëdha me legjislacionin e BE-së.

Për shqyrtimin e propozim-ligjit me procedurë të shkurtuar vendos Kuvendi. Nëse vendimi është pozitiv, atëherë Kryetari i Kuvendit menjëherë e detyron trupin punues amë dhe Komisionin Juridik-Ligjvënës ta shqyrtojë propozim-ligjin.

Trupat punues debatojnë në procedurë si për lexim të dytë.

Domethënë, debatohet për nenet e ligjit një nga një, debatohet dhe merret vendim edhe për amendamentet e parashtruara. Amendamentet mund të parashtrohen deri në fillim të mbledhjeve të trupave punues.

Kur propozim-ligji shqyrtohet me procedurë të shkurtuar, Kuvendi mban edhe debat të përgjithshëm. Leximi i dytë dhe i tretë mbahen në seancën e njëjtë të Kuvendit. Leximi i dytë fillon me shqyrtim të propozim-ligjit, në procedurë të njëjtë si ligjet që miratohen në procedurë të rregullt. Dallimi qëndron në faktin se amendamente mund të parashtrohen edhe gjatë seancës, deri në fillimin e leximit të tretë të propozim-ligjit.

PROCEDURA URGJENTE

Në raste të veçanta ligji mund të miratohet edhe me procedurë urgjente, por vetëm në këto raste: nëse kjo është e domosdoshme për parandalimin dhe mënjanimin e çrregullimeve më të mëdha të ekonomisë; kur këtë e imponojnë interesat e sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit, ose në rast të fatkeqësive më të mëdha natyrore, epidemive ose nevojave të tjera të jashtëzakonshme dhe urgjente. Propozuesi është i obliguar ta arsyetojë propozimin për miratimin e ligjit me procedurë urgjente dhe ta dorëzojë propozimin e ligjit, miratimi i të cilit propozohet.

Për arsyeshmërinë e propozimit, Kuvendi vendos pa debat. Nëse vendimi është pozitiv, Kuvendi i detyron trupin punues amë dhe Komisionin Juridik-Ligjvënës të shqyrtojë propozim-ligjin. Kur propozim-ligji shqyrtohet me procedurë urgjente, nuk mbahet debat i përgjithshëm. Leximi i dytë dhe i tretë mbahen në seancën e njëjtë. Në këtë rast leximi i dytë fillon me shqyrtimin e propozim-ligjit në përputhje me dispozitat e Rregullores së Punës për lexim të dytë. Kur propozim-ligji shqyrtohet me procedurë urgjente, nuk vlejnë afatet kohore të përcaktuara në Rregulloren e Punës.

SHPLLJA DHE PUBLIKIMI I LIGJEVE


Ligjet shpallen me dekret, të cilin e nënshkruajnë Kryetari i Republikës dhe Kryetari i Kuvendit. Kryetari i Kuvendit menjëherë pas miratimit, ligjin ia dorëzon Kryetarit të Republikës që ta nënshkruajë dekretin për shpalljen e tij.

Para se të hyjnë në fuqi, ligjet botohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", maksimum shtatë ditë nga dita e miratimit të tyre, ndërsa hyjnë në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit, përveç se në raste të veçanta të përcaktuara nga Kuvendi me ditën e botimit. Ligjet përveç se në gjuhën maqedonase botohen edhe në gjuhën shqipe.

E DREJTA E VETOS SUSPENDUESE

Kryetari i Republikës mund të vendosë të mos e nënshkruajë dekretin për shpalljen e ligjit. Në këtë rast, Kuvendi përsëri e shqyrton ligjin dhe nëse e miraton me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, Kryetari i Republikës është i detyruar ta nënshkruajë dekretin. Kryetari i Republikës e ka për detyrë ta nënshkruajë dekretin edhe nëse ligji miratohet me dy të tretat e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

MIRATIMI I LIGJIT NË PROCEDURË TË RREGULLT NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Para se të hynë në fuqi, ligjet publikohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut"



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



IMPLEMENTUAR NGA:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Ky publikim është përgatitur nga Instituti Parlamentar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës së Konfederatës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

PSP zbatohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për menaxhimin e ndryshimeve (CMP). Përmbajtja e publikimit në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e SDC.